



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 699/24 Dt. 12.11.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

---

**Procesverbali për Projekt- Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga  
Dhuna ne Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna ne Barazi Gjinore  
2024-2026**

## **Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **28.10.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/10/Njoftim-per-konsultim-publik-per-Planin-Lokal-te-Veprimit-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-Dhuna-ndaj-Grave-dhe-Dhuna-ne-Barazi-Gjinore-2024-2026-Shq-Bosh-Tur-Rom.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42652>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-konsultim-publik-per-planin-lokal-te-veprimit-per-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje-dhuna-ndaj-grave-dhe-dhuna-ne-barazi-gjinore-2024-2026/>

**Me 28.10.2024**, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 08.11.2024**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-me-qytetare-per-planin-lokal-te-veprimit-per-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje-dhuna-ndaj-grave-dhe-dhuna-ne-barazi-gjinore-2024-2026/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/15TfHQzjZQ/>

## **Konsultimi ka filluar në orën 11:10**

**Bashkim Rakaj** ka hapur konsultimin duke përshëndet anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, OSBE- në, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat. Jemi mbledhur sot për dëgjimin e parë publik ku D.P.M.S. do të prezantojë planin e veprimit kundër dhunës në familje dhe në baza gjinore në Prizren. D.P.M.S do të mbështesë fuqishëm mekanizmin komunal kundër dhunës në familje.

**Kumrije Bytyqi:** Koordinatorja e mekanizmit kundër dhunës në familje ka prezantuar Projekt- Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna ne Barazi Gjinore 2024-2026 duke thënë se një falënderim dua të bëjë për Kryetarin e Komunës së Prizrenit z.Shaqir Totaj dhe nënkryetarin e Komunës z.Kujtim Gashi për përkrahjen e vazhdueshme gjatë gjithë procesit.

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore është përpjekje e përbashkët e Mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje (MKLDHF) në Prizren.

Ky plan është hartuar nën koordinimin e Koordinatorës (drejtoresha e qendrës për punë sociale)dhe me përkrahjen e këtij Mekanizmi me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjerë të partnerëve.

Plani i veprimit është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Prizrenit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

**Plani është bazuar** në të gjitha format e dhunës në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*“, plani i veprimit është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit

Marrëveshja e Mirëkuptimit e nënshkruar me 01 mars 2024 , nga Kryetari I Komunës dhe te gjithë institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional me përgjegjësit që rrjedhin nga marrëveshja e mirëkuptimit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore; Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës

në Familje; Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore; Standardet ndërkombëtare , procedurat standarde te veprimit etj.

Duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore (DHF, DHG dhe DHBGJ) dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

### **Plani lokal i veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Prizrenit, synon:**

Të punojë në parandalimin e Dhunës ne Familje, Dhunës ndaj grave dhe Dhunës ne Baza Gjimore dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni; Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant; Të fuqizojmë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të DHF, DHG dhe DHBGJ dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre; Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Pra, ky plan është mbështetur në tri fusha të veprimit, si “**Vetëdijesimi dhe Parandalimi**”; “**Mbrojtja dhe Koordinimi**”; “**Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe ri integrimi**” me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

#### **Vetëdijesimi dhe Parandalimi**

Objektiva Strategjike 1: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ.

Objektiva specifike 1.1: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e DHF, DHG dhe DHBGJ;.

Objektiva specifike 1.2: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin i dhunës ndaj grave dhe DHF, DHG dhe DHBGJ; Mbrojtja dhe Koordinimi”.

**Objektiva Strategjike 2:** Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 2.1:** Funkcionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; **Objektiva specifike 2.2:** Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 2.3:** Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 2.4:** Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ.

#### **Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe ri integrimi**

**Objektiva Strategjike 3:** Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 3.1:** Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 3.2:** Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ.

### **Objektivi pare (I) strategjik**

Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Ngritja e njohurive të mësimdhënësve në identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në DHF, DHG dhe DHBGJ.

1.1.1 Realizimi i sesioneve informuese për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; trajnime të anëtarëve të MK për kornizën ligjore dhe menaxhimin e rasteve; ngritja e kapaciteteve të profesionistëve institucional për Konventën e Këshillit të Evropës; Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ; bashkërendimin e rasteve për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje.

1.1.2 Ngritja e njohurive të mësimdhënësve në identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në DHF, DHG dhe DHBGJ;

1.1.3 Vizitë studimore lidhur me funksionimin e mekanizmit koordinues në trajtimin të rasteve të dhunës në familje.

### **Vetëdijësimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe DHF, DHG dhe DHBGJ;**

1.2.1 Organizimi i fushatës vetëdijësuese për të drejtat e njeriut me fokus të drejtat e grave në kuadër të Fushatës së “16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”;

1.2.2 Realizimi i sesioneve informuese me fëmijë dhe të rinj për rolin dhe përgjegjësit e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës;

1.2.3 Realizimi i sesioneve informuese me gra dhe viktima të dhunës në familje për rolin dhe përgjegjësit e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës;

1.2.4 Organizimi i aktiviteteve jo-formale (përmes artit, eseve, ekspozitave, dramave, etj) me fokus parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

1.2.5 Informimi i publikut përmes rrjeteve sociale për mbrojtjen që iu ofrohet viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ dhe institucionet përkatëse ku duhet të orientohen.

### **Objektivi strategjik II**

**Objektiva Strategjike 1** Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; **Objektiva specifike 2.1:** Funkcionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

2.1.1 Hartimi i Rregullores së Punës të Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

2.1.2 Hartimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për mbrojtje nga DHF,

2.1.3 Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale lidhur me marrjen e masave për parandalim, trajtimin, strehimin dhe mbrojtje të DHF, DHG 2.1.4 Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale.

**Objektiva specifike 2.2: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ.**

2.3.2 Identifikimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave në terren 2.3.1. Grumbullimi i të dhënave të standardizuara mbi DHF, DHG dhe DHBGJ; 2.3.2 Përcaktimi i nevojave, sfidave, përparësive dhe marrja e masave në bazë të analizës së të dhënave për parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF, DHG dhe DHBGJ;

2.3.3 Hartimi i raportit vjetor për mbrojtje nga DHF, DHG dhe DHBGJ; Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore.

### **Objektivi strategjik**

**Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ**

2.4.1 Referimi i rasteve për ngritje profesionale në qendrat e aftësisimit profesional për viktimat e DHF, DHG dhe DHBGJ

2.4.2 Subvencionimi/përkrahja e projekteve për rehabilitim dhe riintergrim të viktimave të DHF, DHG dhe DHBGJ ; Ndërmjetësimi për punësim për viktimat e DHF, DHG ,

2.4.3 Ofrimi i ndihmës për banim, renovim .

### **I. PLANI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT**

Synimi kryesorë i Komunës Prizrenit pa dyshim se është realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite; Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Plan të Veprimit; Për ta vlerësuar cilësinë dhe

efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportoj përparimin në zbatimin e planit në baza vjetore; Koordinatoria e Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Koordinatoria për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike të çdo viti/ në baza gjashtë mujore do të raportojë direkt Kryetarit të Komunës; Me ç ‘rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë “Raportin e Monitorimit” mbi zbatimin, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktivitetëve të parapara në Planin e Veprimit.

**Mybexhele Zhuri:** Kam qene pjese e hartimit të planit komunal i cili është krijuar nga mekanizmat komunal për ta trajtuar dhe parandaluar dhunën në familje. Plani Komunal Kundër Dhunës në Familje është një dokument strategjik që krijohet nga komunat për të trajtuar dhe parandaluar dhunën në familje në mënyrë më efektive dhe gjithëpërfshirëse. Ky plan është i rëndësishëm për disa arsye kryesore dhe ofron disa përfitime të rëndësishme për komunitetin:

#### **Pse Na Duhet Plani Komunal Kundër Dhunës në Familje?**

**Parandalimi dhe Ndërgjegjësimi:** Dhuna në familje është një problem serioz shoqëror që kërkon masa të përbashkëta për parandalim dhe ndërgjegjësim. Plani synon të edukojë komunitetin për ndikimin e dhunës në shëndetin dhe mirëqenien e viktimave dhe të krijojë një kulturë ku dhuna është e papranueshme.

**Koordinimi Ndërinstitucional:** Plani komunal siguron një kornizë për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve si policia, shëndetësia, arsimit dhe organizatat joqeveritare, të cilat luajnë rol në parandalimin dhe trajtimin e dhunës. Kjo ndihmon në krijimin e një qasjeje të integruar dhe më të organizuar për të ndihmuar viktimat.

**Mbështetja për Viktimat:** Përmes planit, krijohen programe për ndihmë dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë strehim, këshillim psikologjik, ndihmë ligjore dhe përfshirje në programet e rimëkëmbjes.

**Statistika dhe Monitorim:** Plani ndihmon në mbledhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje, gjë që ndihmon në monitorimin e përhapjes së problemit dhe në vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra.

#### **Çfarë Ofron Plani Komunal Kundër Dhunës në Familje?**

**Shërbime Mbështetëse për Viktimat:** Plani përfshin masa për të ofruar shërbime të ndryshme për viktimat, si strehimore të sigurta, ndihmë mjekësore, këshillim dhe trajtim psikologjik, si dhe ndihmë ligjore.

**Trajnim dhe Edukim për Institucionet dhe Publikun:** Plani përfshin programe trajnimi për profesionistët që merren me rastet e dhunës në familje dhe fushata ndërgjegjësimi për publikun. Kjo ndihmon në përmirësimin e njohurive dhe kapaciteteve për të adresuar dhe parandaluar dhunën.

**Programe Parandaluese:** Shumë plane përfshijnë programe edukative në shkolla dhe në komunitet për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar marrëdhënie të shëndetshme pa dhunë.

Me këtë plan, krijohen udhëzime dhe protokolle të qarta për veprim, në mënyrë që të gjitha rastet e dhunës të trajtohen në mënyrë të njëtrajtshme dhe profesionale nga institucionet përkatëse.

Plani komunal kundër dhunës në familje është pra një dokument i rëndësishëm që siguron një angazhim të qartë dhe veprime konkrete nga ana e komunës dhe partnerëve të saj për të luftuar këtë fenomen negativ dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe më të shëndetshëm për të gjithë qytetarët.

**Daniel Lezo,** zyrtar i lartë ligjor në OSBE: Shpreh falënderime për punën që është bërë për finalizimin e planit të veprimit dhe jep mbështetje për institucionet në Kosovë për këtë mekanizëm.

**Bashkim Rakaj:** Jeni të ftuar që të merrni pjesë në dhënien e ndonjë mendimi apo ndonjë propozim konkret si ta ndryshojmë apo të përmirësojmë lidhur me këtë temë.

**Haziz Krasniqi:** Ju njoftoj se qytetarët të cilët dëshirojnë të dërgojnë komentet dhe sugjerimet mund të dërgojnë deri me datën 15.11.2024 në e-mail-in zyrtarë [adelina.hoxhaj@rks-gov.net](mailto:adelina.hoxhaj@rks-gov.net) dhe [haziz.krasniqi@rks-gov.net](mailto:haziz.krasniqi@rks-gov.net) dhe pastaj këto komente do të kooperohen në planin final.

**Tringa Kasemi:** Nuk kam ndonjë koment sepse kam qene në hartimin e këtij plani, mirëpo pres komentet online dhe këtu për diskutim. bëj thirrje Komunës së Prizrenit që të kostoj planin e veprimit.

**Bashkim Rakaj:** Natyrisht që një pjesë e rëndësishme është edhe buxheti i realizimit të planit ku është parashikuar buxheti dhe besoj që është mjaftueshëm.



Kërkesat e qytetarëve të parashtruara gjatë mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë:

Gjatë mbajtjes së konsultimit nga ana e qytetarëve që kanë qenë në konsultim nuk është parashtruar asnjë kërkesë.

Në këtë vegëz: <https://fb.watch/vJQGbGaBQF/>, mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 11:30**

Procesmbajtës: